

## KONTRATË SHIT – BLERJE KUOTASH KAPITALI

Në Durres, me datë 11.11.2021, (dymijë e njëzetënjë), në selinë e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "ECOS2020", regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS: M01424511H, me seli në " Durres, Zona kadastrale n. 8518, nr pasurie 175, shkalla 1, ap. 61, kati 7, lagja 13, Plazh Durres" palët ose përfaqësuesit e tyre:

- Zonja Cristina Romano, e datelindjes 08.03.1984, lindur në Matera, banuese në Cassano delle Murge, me letërnjoftim CA88975EV dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

### SHITESI

- Zonja Marina Braho, lindur ne Patos me 26.01.1983 dhe banuese ne Tirane, me Passaporto BG8863628 dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

### BLERESI

#### MEQENËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE:

-Bazuar në ekstraktin e regjistrimit tregtar rezulton se me datë 17.02.2020 është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ECOS2020", me kapitalin në shumën 200.000,00 (Dyqind mijë) lekë.

-Ortaku zoterues i 1 kuote te zakoneshme te kapitalit te Shoqërisë ECOS2020 qe perfaqeson 80% te kapotalit fillestar, Z. Klaidi Kulja, lindur ne Durres me date 25.05.1988, ID. ID I80525121A, ka miratuar, duke hequr dore nga e drejta e parablerjes, shitjen e kuotave të Kapitalit ne pronesi te Znj. Cristina Romano tek Znj. Marina Braho, me vetedeklarim qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

#### NENI 1

##### TITULLI I PRONËSISË MBI KUOTAT E KAPITALIT

Zonja Cristina Romano zotëron 1 kuotë të zakonshme të Kapitalit të Shoqërisë, 20%, në vlerën 40,000 (dyzet) mijë lekësh, kjo gjë e provuar dhe nga Ekstrakti I Shoqërisë.

#### NENI 2

##### OBJEKTI I KONTRATËS, VLEFTA E SHITJES SË KUOTAVE DHE HYRJA NE FUQI E KONTRATES

Pala Shitëse, Znj. Cristina Romano I shet Znj. Marina Braho 1 kuotë, e cila është vlera e plotë e kuotës që zotëron në shoqëri prej 20%, në vlerën 40,000 (dyzet mijë) lekë. Kjo kuotë është e lirë nga çdo bllokim dhe çdo barrë.


Kuota shitet me çmimin e kapitalit prej 40.000 (dyzet mije) lek.

Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere, ne momentin e nenshkrimit nga Palet.

#### NENI 3

##### DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

Shitësi, me anë të kësaj Kontrate deklaroon dhe garantoon në lidhje me Shoqërinë si dhe me Transaksionin dhe për të gjitha çështjet që parashikohen në këtë Kontrate. Shitësi, gjithashtu



qëllimet e Transaksionit. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo i keqpërdorur.

#### **LLOGARITË**

Llogaritë e Shoqërisë të Datës së Fundit Kontabël që janë vënë në dispozicion përfituesit, janë përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me Parimet e Përgjithshme të Kontabilitetit të pranuar në Shqipëri.

#### **REGJISTRIT KONTABËL DHE LIBRA TË TJERË TË SHOQËRISË**

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë janë të azhurnuara, mbahen në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në këto regjistra dhe libra kontabël janë mbajtur rrequllisht dhe në përputhje me ligjet Shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikat e zbatueshme të vendit.

#### **AKTIVET E TRUPËZUARA**

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë, të regjistruar dhe të tregtueshem mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, që pasqyrohen në Llogaritë e Datës së Fundit Kontabël apo që janë fituar pas kësaj date dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrimi ose të drejte të çfarëdo lloji në përfitim të palëve të treta.

#### **AKTIPET E PATRUPËZUARA**

Shoqëria është pronarja e vetme e patentave, emrave tregtarë, njohuri teknike (know-how) të saj si dhe çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për kryerjen e Aktivitetit të saj, ("Aktivet e Patrupëzuara") dhe nuk është në shkelje të asnjë prej Aktiveve të Patrupëzuara të saj. Këto Aktive të Patrupëzuara janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife ose ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

#### **GARANCITË, DETYRIMET DHE DËMSPËRBLIMET**


Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të asnjë marrëveshje siguroese, dëmshpërblimi apo marrëveshje tjetër, për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar, ose detyrim tjetër në lidhje me palët e një pale të tretë.

#### **NENI 4**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet që të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, zbatimi ose interpretimi i saj të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se kjo nuk funksionon, palët mund t'i drejtohen çdo gjykate nën juridiksionin shqiptar.



**NENI 5**

**TË NDRYSHME**

Kjo kontratë është shkruar në gjuhën shqipe në dy kopje, ku secila e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë, quhet origjinale. Kjo kontratë nënshkruhet rregullisht me vullnetin e lirë të palëve.




Zonja Cristina Romano deklaron qe kupton plotësisht përmbajtjen e kësaj kontrate pasi është njohëse e gjuhës Shqipe.

**PALËT**

**Shitësi**

**Cristina Romano**



**Blerësi**

**Marina Braho**

